




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor

**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 19.01.2026 DERI MË 23.01.2026

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për për emërimin e pëkohshëm të drejtorit të ShFMU "Heronjë e Kososvës" në Hocë të Vogël.	NRP-02-6924-2026
2.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-6925-2026
3.	Vendim për caktimin e komisionit për caktimin e komisionit për inspektimin e objektit të QMF-së në Fortesë.	NRP-02-6927-2026
4.	Vendim për për qasje në dokumente publike.	NRP-02-6930-2026
5.	Vendim për miratimin e Planit Komunal për Integritet për vitin 2026 në Komunën e Rahovecit.	NRP-02-6931-2026
6.	Vendim për vazhdimin e punës për vitin 2026 të Ekipit Rajonal për projekte Komunale (ERPK) në objektin e institucionit të Komunës së Rahovecit	NRP-02-6932-2026
7.	Vendim për caktimin e jurisë profesionale për vlerësimin e punimeve dhe përzgjedhjen e poezisë dhe prozës me rastin e manifestimit tradicional kulturor e përkujtimor "Flaka e Janarit".	NRP-02-6937-2026
8.	Vendim për caktimin e zyrtarit Kryesor Financiar.	NRP-02-6938-2026
9.	Vendim për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull "Sherbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit"	NRP-02-6941-2026



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6941 Nr. i faq./Br.str/No.pg 197

Data/Datum/Date 26 / 01 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, kërkesës dhe rekomandimit të Menaxherit të Projektit 3 Nr. Prot. 626 të datës 23.01.2026 për ndërprerjen e kontratës me titull: “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit” me Nr. identifikues 623-24-7267-2-1-1/C612, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit” me nr. identifikues 623-24-7267-2-1-1/C612 dhe me nr. prot. 3043, e datës 24.9.2024.
2. **Obligohet** Zyra e Prokurimit që t’i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi, për ndërprerjen e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Alma Kastrati nga fshati Radoste (Malësi e Vogël), komuna e Rahovecit, ka parashtruar kërkesë të menaxherit i kontratës, 3 nr. prot 623, të datës 23.1.2026, për shkëputjen e kontratës me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me nr. identifikues 623-24-7267-2-1-1/C612 dhe me nr. prot. 3043, e datës 24.9.2024, e cila ishte e angazhuar si konsulente individuale – hulumtuese e tregut për prodhime bujqësore.

Pas kësaj, menaxheri i kontratës, me kërkesën 3 nr. prot. 626, të datës 23.1.2026, ka kërkuar dhe njëherit ka rekomanduar Zyrтарin Kryesor Administrativ, ndërprerjen e kontratës me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me nr. identifikues 623-24-7267-2-1-1/C612 dhe me nr. prot. 3043, e datës 24.9.2024, me të cilën Alma Kastrati ishte e angazhuar si konsulente individuale – hulumtuese e tregut për prodhime bujqësore.

Duke u bazuar në nenin 10 të Kushtet e Përgjithshme të Kontratës me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me nr. identifikues 623-24-7267-2-1-1/C612, si dhe dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, janë

përbushur të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kësaj kontrate me kërkesë të ofruesit të shërbimeve.

Pas administrimit të të gjitha provave, kryetari i Komunës ka konstatuar që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës me Nr. Prot. 3043, të datës 24.9.2024, me titull “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit”, me nr. identifikues 623-24-7267-2-1-1/C612.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 10 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në autoritetin kontraktues.

Me vendim të njoftohen:

- *Alma Kastrati,*
- *Zyra e Prokurimit,*
- *Menaxheri i projektit,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6024 Nr. i faq./Br.str./No.pg 195

Data/Datum/Date 21 / 01 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), neni 38 i Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/2011”), neni 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, neni 74 dhe neni 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e përkohshëm të drejtorit të ShFMU “Heronjtë e Kosovës” në Hoçë të Vogël

1. Skender Gashi nga fshati Hoçë e Vogël, komuna e Rahovecit, **EMËROHET** përkohësisht drejtor në ShFMU “Heronjtë e Kosovës” në Hoçë të Vogël.
2. I lartpërmenduri sipas pikës 1 të këtij vendimi, emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU “Heronjtë e Kosovës” në Hoçë të Vogël, nga data 21.1.2026 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.
3. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i takon kompensimi i pagës së drejtorit/eshës së ShFMU-së deri në përfundim të emërimit të përkohshëm.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me nr. prot. 02/6711, i datës 14.11.2025.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh se i emëruari i përkohshëm i drejtorit të ShFMU “Heronjtë e Kosovës” në Hoçë të Vogël, z. Driton Krasniqi, nuk mund ta kryejë tani e tutje këtë pozitë, Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit, ka parashtruar kërkesë për emërimin e përkohshëm të drejtorit në ShFMU “Heronjtë e Kosovës” në Hoçë të Vogël.

Pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Arsim, duke u bazuar në nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe të emërimit të drejtorëve dhe të zëvendës drejtorëve, të mësimdhënësve, të bashkëpunëtorëve profesionalë, të asistentëve, të instruktorëve dhe të sekretarëve

në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, Skender Gashi nga fshati Hoçë e Vogël, emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU “Heronjtë e Kosovës” në Hoçë të Vogël.

I lartpërmenduri emërohet përkohësisht drejtor në ShFMU “Heronjtë e Kosovës” në Hoçë të Vogël, nga data 21.1.2026 deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës së këtij institucioni arsimor.

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit, Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në kuadër të komunës së Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

- *Skender Gashi nga fshati Hoçë e Vogël,*
- *Drejtoria për Arsim,*
- *NJMBNJ, dhe*
- *Arkivi.*

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [REDACTED] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0003076/26, e dt. 13.01.2026 për ndihmë financiare prej 600.00€ (gjashtëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. [REDACTED] nga Rahoveci me datë 21.01.2026 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoninë (lindje) pasi që me datë 10.01.2026 ka lindur **Djal** në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për **znj. [REDACTED]** si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- **Znj. [REDACTED]** nga Rahoveci,
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6927 Nr. i faq/Br.str/No.pg 195

Data/Datum/Date 22 / 01 / 26

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 44 dhe nenit 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016”), nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe kërkesës së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, të datës 21.1.2026, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për inspektimin e objektit të QMF-së në Fortesë

1. **Caktohet** komisioni për inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes faktike të QMF-së në Fortesë, pas vërshimeve të shiut të datës 5, 6 dhe 7 janar 2026, në këtë përbërje:
 - 1.1. Samir Mustafa – DShPS, kryesues;
 - 1.2. Elbunit Kryeziu – drejtor i QKMF-së, anëtar;
 - 1.3. Metush Isma - inspektor, anëtar;
 - 1.4. Dhurata Ukaj - mjeke, anëtar;
 - 1.5. Avdi Kastrati - infermier, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes faktike të QMF-së në Fortesë, pas vërshimeve të shiut të datës 5, 6 dhe 7 janar 2026, nëse ky objekt i plotëson kushtet higjienike – sanitare për funksionim dhe dhënien e shërbimeve shëndetësore për komunitetin e fshatit Bellacërkë (Fortesë) dhe më gjerë.
3. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më 28.1.2026.
4. Obligohet komisioni profesional që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim dhe rekomandim për kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- DShPS-ja, dhe
- Arkivi.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016”), nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 13/2019”), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me nr. prot. 02/6910, e datës 15.1.2026 për qasje në dokumente publike nga Enis Veliu i medias online “Frontonline” dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë listën e pronave të komunës së Rahovecit të dhëna në shfrytëzim (me qira) afatshkurtër dhe afatgjatë, si në vijim:
 - 1.1. Prona – përshkrimi, sipërfaqja dhe vendndodhja;
 - 1.2. Përfituesi – emri i personit fizik apo juridik, dhe
 - 1.3. Shuma e cila paguhet në muaj apo në vit nga përfituesi.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me nr. prot. 02/6910, e datës 15.1.2026 për qasje në dokumente publike nga Enis Veliu i medias online “Frontonline”.

Pas shqyrtimit të kërkesës, ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike si në dispozitiv të këtij vendimi dhe atë:

- Prona – përshkrimi, sipërfaqja dhe vendndodhja;
- Përfituesi – emri i personit fizik apo juridik, dhe
- Shuma e cila paguhet në muaj apo në vit nga përfituesi.

Kërkesa për qasje në dokumente publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

Vendimi u dërgohet:

- **Blerta Gashit**, zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP-së,
- **Enis Velit** të “Frontonline”, dhe
- **Arkivit**.

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No 633A	Nr. i faq./Br.str./No.pg 196
Data/Datum/Date 22 / 01 / 26	
Kryetari i Komunës	

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44 dhe nenit 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), nenit 25 të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/2022"), Udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuara nga Agjencia për Prandalimin e Korrupsionit, nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Komunal për Integritet për vitin 2026 në Komunën e Rahovecit

1. **Miratohet** Plani Komunal për Integritet për vitin 2026 në Komunën e Rahovecit.
2. Shtojcë e këtij vendimi është Plani Komunal për Integritet për vitin 2026 në Komunën e Rahovecit me Nr. Prot. 02/6931 i datës 22.01.2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset personi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit Komunal për Integritet dhe drejtorë të drejtorive.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **Valmir Gashi, Personi përgjegjës,**
- **Drejtor të Drejtorive,**
- **Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, dhe**
- **Arkivi.**

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality of Rahovec
Kryetari i komunës – Predestnik Opštine – Municipality mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA E KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6932 Nr. i faq/Br.str/No.pg 196
Data/Datum/Date 22 / 01 / 2026
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 74 dhe 92 të paragrafit 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, procesverbalit të Kuvendit të AZhR “Jug”, të datës 27.2.2020, Marrëveshjes për Bashkëpunim Ndërkomunal në Zonën Ekonomike “Jug”, të datës 16 dhjetor 2008, Termave të Referencës për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit Rajonal për Projekte Komunale (ERPK) Nr.27022020ERPK, kryetari i Komunës, bën këtë:

VENDIM

1. Vazhdohet puna edhe për vitin 2026 e Ekipit Rajonal për Projekte Komunale (ERPK) në objektin e institucionit të Komunës së Rahovecit.
2. Obligohet AZhR “Jug” që t’i fillojë të gjitha procedurat për funksionalizmin e ERPK-së sipas termave të referencës së themelimit dhe të funksionimit të ERPK-së.
3. Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- AZhR “Jug” dhe
- Arkivit.


Smajl Latifi

Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe konkursit për art letra, poezi dhe prozë, të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me datë 06.01.2026, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e jurisë profesionale për vlerësimin e punimeve dhe përzgjedhjen e poezisë dhe prozës me rastin manifestimit tradicional kulturor e përkujtimor “Flaka e Janarit”

1. Caktohet juria profesionale për vlerësimin e punimeve dhe përzgjedhjen e poezisë dhe prozës me rastin manifestimit tradicional kulturor e përkujtimor “Flaka e Janarit”, në këtë përbërje:
 - 1.1. Qemajl Krasniqi, kryesues
 - 1.2. Qefsere Bajrami, anëtare
 - 1.3. Ersula Dula, anëtare
 - 1.4. Adelina Shabandula, anëtare
 - 1.5. Fjolla Duraku, anëtare
2. Juria profesionale ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin e të gjitha punimeve dhe krijimtarive letrare dhe përzgjedhjen e krijimtarisë më të mirë letrare dhe propozimin për krijimtarinë më të mirë letrare për dhënien e çmimit me rastin manifestimit tradicional kulturor e përkujtimor “Flaka e Janarit”.
3. Obligohet juria profesionale që këto punë ti kryejë duke u bazuar në konkursin për art letrar, poezi dhe prozë, të shpallur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me datë 06.01.2026 si dhe ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
4. Juria profesionale do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e jurisë dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të jurisë,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6338 Nr. i faq./Br.str/No.pg 196
Data/Datum/Date 23 / 01 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 1092 e dt. 27.03.2015, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF)

1. Ekrem Bytyqi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave, në Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit, **CAKTOHET** Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF) në Komunën e Rahovecit.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit Kryesor Financiar (ZKF) në Komunën e Rahovecit janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Ekrem Bytyqi dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim prodhon efekt juridik për vitin fiskal 2026.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Ekrem Bytyqi,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës

